Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/96
Datë 04.03.2020

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 25.02.2020 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Akreditohet "English Language School" Shpk, me adresë, Bulevardi Bill Klinton, Su5/7, H12, Kati 1 dhe 2; si dhe Rr. Muharrem Fejza, Lirimi ACL, Lam C/1-1, Rruga B, Prishtinë për periudhën tre vjeçare 25.02.2020 deri 24.02.2023 për të ofruar vlerësuar dhe certifikuar këtë kualifikim:

   1.1. Gjuhë angleze; Numri i kandidatëve i lejuar për grup: 15 kandidatë.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime, janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raporti i vetë-vlerësimit; vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi. Numri i kandidatëve i lejuar për grup është bazuar në hapësirën fizike, pajisjet dhe mjetet tjera të këtij institucioni.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- English Language School Shpk
- AKK

Kryetarja e KD të AKK-së
Violeta Dema